



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nr. 2279 Prot.

Tiranë, më 14.07. 2023

**Lënda:** Kërkesë për mocion me debat publik URGJENT në Parlament

**Drejtuar:** Znj. Lindita NIKOLLA  
KRYETARE E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Zonja Kryetare,

Në datë 7 korrik 2023, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) ka dorëzuar në Kuvendin e Shqipërisë kërkesën për dhënien e autorizimit për arrestimin e ish zëvendës kryeministrit, ish ministrit të Financave dhe Ekonomisë, deputetit aktual të Partisë Socialiste, Arben Ahmetaj.

Arben Ahmetaj akuzohet për:

- "Mosdeklarim apo fshehje të pasurive",
- "Korrupsion pasiv" si dhe
- "Pastrim parash"

Në kërkesën e SPAK theksohet se kërkohet autorizim nga Kuvendi i Shqipërisë, për arrestimin ose heqjen e lirisë dhe ushtrimin e kontrollit personal dhe të banesës së deputetit.

Kjo dëshmon edhe një herë që kjo aferë është aq e madhe sa përfshin edhe organet e qeverisë deri në majën e kupolës ku përfshihen edhe Ministra dhe zyrtarë të tjerë dhe Kryeministri.

Thellësisht të shqetësuar, bazuar në nenin 98 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, po dorëzojmë këtë kërkesë për mocion me debat publik URGJENT në Kuvend, në lidhje me aferën e inceneratorëve.


Neni 98, pika 2 e rregullores kërkon mbledhjen brenda tre ditësh të Konferencës së Kryetarëve nga ana e Kryetares së Kuvendit për vendosjen e datës së zhvillimit të mocionit në seancë plenare. Por meqenëse bëhe fjalë për


një çështje të një rëndësie të madhe me interes të gjerë publik, kërkojmë nga ana juaj:


- Mbledhjen URGJENTE, brenda ditës së premtë datë 14.07.2023, të Konferencës së Kryetarëve dhe futjen si çështje e parë në rendin e ditës
- në seancën plenare të dt 20.7.2023, të mocionit me debat rreth skandalit të inceneratorëve ku nga informacionet e bëra publike, përvec ish zv.kryeministrit Ahmetaj janë të përfshirë edhe Ministria të tjerë aktualë, ish ministra, deputetë e funksionarë të tjerë të lartë;
  - Çdo deputet të ketë të drejtën e diskutimit 10 minuta;
  - Lista e folësve për Mocionin me Debat të fillojë detyrimisht me deputetët iniciues të Mocionit me Debat dhe më pas mund të vijojnë folësit apo diskutantët e tjerë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**DEPUTETËT:**


Alban Vashi 

Toita Hal 


Aslan Dapjari 


Kastriot Duroli July 2023.




Edmond Spato Spato


Jedovin Hasan. 


Edi PALOKA


ISUF 


Elda Hoti 


Agon Doci   
Karem Jakumtas   
Greta Bardeli 

Lindita Metelid 

Oerd Bylyle bashi 

Seine Koto 

Reza Nohri 

Suli Nenci 

Petar Vanli 